



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 10, datë 5.02.2020

PËR

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË
STREHIMIT “SUBVENCIONI I QIRASË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutë, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr.22/2018, “Për strehimin Social”, vendimit nr. 361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional”, vendimit nr. 362, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe te afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencionit i qirasë”, hartuar sipas udhëzuesit operacional bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, zbatohen parashikimet e vendimit nr. 91, datë 26.07.2018, të Këshillit Bashkiak “Për zbatimin e udhëzuesit operacional mbi përfitimin e bonusit të strehimit në Bashkinë Tiranë”.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikun, Njësitë Administrative dhe Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

K R Y E T A R I

TONI GOGU

RELACION

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT “SUBVENCIONI I QIRASË”

Në mbështetje të nenit 24 të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet se Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”, ka për objekt të tij administrimin dhe shpërndarjen së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim, si dhe referuar nenit 15, pika 5 të po këtij ligji përcaktohet se lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës për përftimin nga programi i bonusit të strehimit vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Me vendimin nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, janë për caktuar dokumentacioni dhe procedurat me qëllim përftimin e programeve sociale të strehimit.

Një nga format e trajtimit me strehim të familjeve në nevojë është dhënia e subvencionit të qirasë në tregun e lirë, i cili ka nisur si iniciativë e Bashkisë së Tiranës në vitin 2007.

Bashkia e Tiranës ka vijuar me ofrimin e përftimit të bonusit të strehimit, ku sipas së cilit subvencionohet një pjesë e konsiderueshme e qirasë së banesës, për familjet të cilat jetojnë me qira dhe kanë të ardhura të pamjaftueshme për ta përballuar atë.

Drejtorisë së Strehimit Social i lindi nevoja të hartojë një udhëzues për mënyrën e funksionimit të përftimit të subvencionit të qirasë, mbështetur në arsyetimin si më poshtë vijon:

- Unifikimi i procedurave që do të ndiqen midis strukturave të Bashkisë Tiranë, me qëllim krijimin e lehtësirave të nevojshme për aplikimin në këtë program social strehimi.
- Përshtatje me ndryshimet e reja ligjore dhe vënia në zbatim e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë auditimit.
- Numri i madh i aplikimeve për bonus strehimi, të cilat, tashmë, si rezultat i miratimit dhe zbatimit të reformës territoriale - administrative, dërgohen edhe nga njësitë e reja administrative të Bashkisë Tiranë.
- Afati i gjatë kohor në skemën e përftimit të bonusit të strehimit të familjeve përfituese ndër vite 2008-2018.
- Domosdoshmëria e vlerësimit social - ekonomik paraprak të familjeve të cilat aplikojnë për t'u trajtuar me Bonus Qiraje.

Administrimi i subvencionit të qirasë dhe masa e subvencionit të qirasë së banesës.

1. Subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.

2. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përftimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

3. Aplikimi i individit/familjes për të përfituar nga subvencionimi i qirasë do të bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve për subvencionimin e qirasë miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndërtohet banesa. Kur subvencionimi i qirasë financohet pjesërisht ose plotësisht nga qeverisja qendrore, lista e përfituesve, e miratuar nga bashkia, i përcillet ministrisë përgjegjëse për strehimin, e shoqëruar me kërkesën për financim.

Subvencioni i qirasë iu shpërndahet me vendim të Këshillit Bashkiak, atyre familjeve të cilat kanë paraqitur kërkesën për strehim duke plotësuar formularin tip, dhe dorëzimin e dokumentacionit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore të strehimit.

Vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion. PAGESA që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25 për qind të të ardhurave të familjes. Mbështetja nga buxheti i shtetit dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore për përfituesit nga programet sociale të strehimit jepet pas verifikimit të gjendjes ekonomike e financiare të familjes. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes kryhet nga administratorët shoqërorë, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore

Procedurat për përfitimin e nga programi subvencioni i qirasë

1. Fazat e aplikimit:

Aplikimi për të përfituar nga subvencionimi i qirasë, do të bëhet me dy faza. Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga ky program, sipas ligjit nr. 22/2018. Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që plotësojnë kushtet për t'u trajtuar me këtë program.

1.1 Faza e parë e aplikimit:

A) Aplikimi pranë Njësisë Administrative/ Lagjeve

Të drejtën të paraqesin kërkesë për përfitimin nga programet sociale e kanë familjet dhe individët që ka mbushur moshën 18 vjeç, të regjistruar në zyrat e gjendjes civile në njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 13 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social.

Plotësimi i formularit për aplikim për subvencionin e qirasë pranë Njësisë Administrative/ Lagjeve, realizimi i vlerësimit social-ekonomik dhe depozitimi i tyre në Bashkinë Tiranë.

Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre për të përfituar nga programet e strehimit social, sipas ligjit nr. 22/2018. Në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar me njërin prej programeve të strehimit.

Çdo aplikant, i cili kërkon të trajtohet me subvencionimin e qirasë duhet të drejtohet pranë zyrës së urbanistikës në Njësinë Administrative/Lagjen për të plotësuar formularin e strehimit tip, sipas formatit të miratuar nga Këshilli Bashkiak, bazuar në modelin që i bashkëlidhet këtij vendimi, Aneksi 3 dhe sipas vetedeklarimit Aneksi 5 Çdo individ/familjeje që paraqet kërkesën, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, nëse ka të tilla Aneksi 6. Njësitë Administrative/Lagjet sigurojnë dokumentacionin që mbajnë apo përgatisin organet publike në vend, duke përjashtur aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre, vetëm nëse aplikanti depoziton deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve të lidhura me të, sipas formatit tip që i bashkëlidhet këtij vendimi si Aneksi 7.

Formularit të strehimit duhet t'i bashkëlidhen dhe dokumentat e mëposhtëm:

- Deklaratën e vërtetësisë së informacionit të pasqyruar në formularin e strehimit, me anë të së cilës aplikuesit i bëhen të njohura edhe përgjegjësitë ligjore që ai ka në lidhje me dhënien e një informacioni dhe fakteve të rreme,
- Kopjen e kartës së identitetit të aplikuesit;
- Çertifikatën familjare.
- Kontratë qiraje të nënshkruar nga të dy bashkëshortët/bashkëjetuesit dhe numër llogarie të qiradhënësit/pronarit social
- Vlerësimi social ekonomik
- Vërtetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës sipas modelit të këtij udhëzuesi

B) Seleksionimi i kërkesave nga Drejtoria e Strehimit Social

Drejtoria e Strehimit Social, realizon procesin e seleksionimit të formularëve të vlefshëm sipas akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e subvencionit të qirasë.

Drejtoria e Strehimit Social, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë dhe Njësitë Administrative, brenda 7 shtatë ditëve kalendarike nga momenti i depozitimit të Formularëve nga Njësitë Administrative, i kërkon me shkrim aplikantit të korrigjojë pasaktësitë brenda 7 ditëve kalendarike nga momenti i njoftimit. Kur kërkesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar 7 ditor, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet aplikantit.

1.2. Faza e dytë e aplikimit:

A) Dorëzimi i dokumentacionit

Familjet që rezultojnë të sukseshme në fazën e parë të aplikimit, brenda 15 (pesmbëdhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit nga Drejtoria e Strehimit, paraqesin pranë Zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashki Tiranë dhe dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimin nr. 384 date 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëvetëqeverisjes vendore”, që vërteton deklarin dhe vërtetësinë e plotësimit të formularit të subvencionimit të qirasë, në bazë të të cilit janë përzgjedhur fitues.

Individi/familja pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta ose të ulëta, që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

B) Seleksionimi i formularëve dhe dokumentacionit

Drejtoria e Strehimit Social seleksionon dhe vlerëson paraprakisht dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit, brenda 10 dhjetë ditëve kalendarike.

C) Shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit nga Komisioni i Strehimit

Drejtoria e Strehimit Social vendos në dispozicion të Komisionit të Strehimit të gjithë formularët e seleksionuar si të vlefshëm gjatë fazës së parë të shqyrtimit, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit. Çdo formulari do t’i bashkëlidhet edhe “Lista e inventarit” (bashkëlidhur këtij udhëzuesi si Aneksi nr. III, i cili përmban të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit dhe i nënshkruar nga nëpunësit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.

Komisioni i Strehimit mbledhet në datën e caktuar në njoftimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, por jo më pak se 1 (një) herë në 2 (muaj).

Drejtoria e Strehimit Social njofton Komisionin e Strehimit për mbledhjen e radhës e cila nuk duhet të jetë më vonë se data 15 e muajit pasardhës, duke i vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi, së bashku me Formularin e Strehimit.

D) Shpallja e listës përfituese nga Komisioni i Strehimit

Komisioni i Strehimit, në bazë të dokumentacionit të dërguar nga aplikuesit dhe kritereve për përzgjedhjen e përfituesve, harton listën e familjeve fituese dhe jo fituese.

E) Njoftimi i aplikantëve që nuk rezultojnë përfitues të subvencionit të qirasë

Drejtorja e Strehimit Social, brenda 10 ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve nga Këshilli Bashkiak njofton përmes shkresave zyrtare çdo aplikues, i cili në bazë të vlerësimit të kryer nga Komisioni i Strehimit, nuk rezulton fitues në këtë program social strehimi, duke i arsyetuar edhe shkaqet e mospërzgjedhjes së tyre. Aplikantët jofitues kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre pranë Kryetarit të Bashkisë/ strukturës përgjegjëse për ankimim brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit ose pranë Gjykatës që ka për kompetencë shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve.

F) Miratimi i listave përfundimtare në Këshillin Bashkiak

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, harton dhe përgatit relacionin dhe projekt-vendimin për miratimin e listës përfituese, jo më vonë se 3 ditë pas zbardhjes së procesverbalit të komisionit, dhe e paraqit në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak.

G) Publikimi i listës përfituese

Drejtorja e Strehimit Social në bashkëpunim me Drejtorinë e Komunikimit me Qytetarët bën publike listën përfundimtare të përfituesve të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

H) Pagesa Financiare

Drejtorja e Strehimit Social përgatit list pagesën e përfituesve me vlerat përkatëse. Pas kryerjes së kontrollit financiar të këtij dokumentacioni, Drejtorja e Financës fillon procedurën e shpërndarjes së pagesës së subvencionit të qirasë. Pagesa e qirasë do të lëvrohet në emër të pronarit social ose në emër të qiradhënësit në rastin e subvencionit të qirasë në tregun e lirë. Për këtë arsye bashkëlidhur me kontratën e qirasë, duhet dhe numri i llogarisë së qiradhënësit/pronarit social ku do të derdhet pagesa e subvencionit të qirasë. Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesit që nga data e aplikimit, por jo më shumë se 3 muaj, pavarësisht nga data e miratimit të vlerës së subvencionit për përfituesin konkret.

Sa më sipër, Subvencioni i qirasë si një programet sociale të strehimit nuk kufizohet vetëm nga ekzistenca e pronarit social, por referuar legjislacionit në fuqi, ndahet në dy instrumente:

1. Subvencioni i qirasë në pronësi të pronarit social (neni 37 i ligjit nr. 22/2018)
2. Subvencioni i qirasë në tregun e lirë (neni 38 i ligjit nr. 22/2018)

Pronari Social dhe Administrimi i subvencionit të qirasë në pronësi të tij.

Bazuar në nenin 23 të ligji 22/2018 “Për Strehimin Social” çdo subjekt publik, përveç njësisë të vetëqeverisjes vendore, si edhe çdo subjekt privat, që investon në banesa sociale me qira ose që disponon banesa për t'i dhënë me qira, për familjet në nevojë për strehim, regjistrohet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore me statusin e “Pronarit social”. Pronari social mbështetet nëpërmjet financimeve për subvencionin e qirasë për familjet përfituese Subvencioni paguhet drejtpërdrejt në llogari të pronarit, ndërsa qiramarrësi përfiton vetëm të drejtën për të përdorur banesën me qira.

Administrimi i Subvencionit të qirasë në tregun e lirë.

Rregullat e përgjithshme mbi subvencionimin e qirasë në tregun e lirë zbatohen të njëjta edhe në këtë rast. Subvencioni i qirasë në tregun e lirë iu shpërndahet me vendim të Këshillit Bashkiak, atyre familjeve të cilat kanë paraqitur kërkesën për strehim duke plotësuar

formularin tip, dhe dorëzimin e dokumentacionit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore të strehimit.

Bazuar në nenin 38 të ligjit 22/2018 vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion. Paguesa që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25 për qind të të ardhurave të familje. Subvencioni paguhet drejtpërdrejt në llogari të qiradhënësit, ndërsa qiramarrësi përfiton vetëm të drejtën për të përdorur banesën me qira. Administrimi i subvencionit të qirasë i nënshtohet procedurave të përgjithshme të parashikuara sipas këtij udhëzuesi.

Rregulla edhe më të detajuara në lidhje me zbatimin e këtij programi janë parashikuar në udhëzuesin operacional, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e Projektvendimit, si Shtojca nr. 1.

Sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkiak Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencioni i qirasë”, hartuar sipas udhëzuesit operacional.

Duke shpresuar për miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

Znj. Borana Rubjeka

Specialist, Sektori i Kontrollit dhe Menaxhimit të Strehimit

Znj. Ornela Kurti

Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Z. Edison Zana

Përgjegjës i Sektori të Kontrollit dhe Menaxhimit të Strehimit

Znj. Jonida Rudaj

Përgjegjës, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Z. Dorian Hatibi

Drejtor, Drejtoria e Strehimit Social

Znj. Laura Deliu

Drejtor, Drejtoria Juridike

Znj. Anisa Subashi

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale

Znj. Alban Dokushi

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit

Znj. Jonida Halili

Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Z. Anisa Ruseti

Zv/Kryetar i Bashkisë Tiranë

Znj. Esmeralda Demiraj
Përgjegjës i Këshillit Bashkiak

Z. Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DRAFT-UDHËZUES OPERACIONAL

**PËR
MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË
STREHIMIT “SUBVENCIONI I QIRASË”**

Janar 2020

Shkurtime të përdorura gjatë hartimit të materialit:

Drejtoria e Strehimit Social	DSS
Komisioni i Strehimit	KS
Vendim i Këshillit Bashkiak	VKB
Vendim i Këshillit të Ministrave	VKM
Njësia Administrative	Nj.A
Formulari i Strehimit	FS

1. Hyrje

Bazuar në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin Social” subvencioni i qirasë i mundësohet familjeve në nevojë për strehim në mungesë të aftësive paguese, në përputhje me buxhetin vjetor të Bashkisë Tiranë.

Objekti i këtij ligji ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm nëpërmjet ndihmës së institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Dhënia e subvencionit të qirasë është një nga format e trajtimit me strehim për familjet në nevojë, e cili ka nisur si iniciativë e Bashkisë së Tiranës në vitin 2007.

2. Misioni

Programet sociale për strehim janë programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Më specifikisht, programi social i strehimit “Subvencioni i qirasë”, është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale”.

2.1 Baza ligjore

Hartimi dhe zbatimi i programeve sociale për strehim mbështetet në ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social” (në vijim referuar si “Ligji 22/2018”) dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, Vendimit nr. 361 datë 29.05.2019 “ Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional” në vijim referuar si VKM 361/2019; Vendimin nr. 362, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, në vijim referuar si VKM 362/2019; VKM nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të

përfiturar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”), në vijim referuar si VKM 384/2019, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004 i Këshillit të Ministrave “Për normat e Strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit” në vijim referuar si VKM 814/2004.

Referuar ligjit të strehimit, aktualisht mund të aplikohen këto programe sociale strehimi:

- a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;
- b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
- c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;
- ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;
- d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;
- dh) programi i banesave të specializuara.

Në bazë të ligjit 22/2018 zbatimi dhe implementimi i programeve sociale të strehimit mund të bëhet nga organet e pushtetit qendror dhe/ose nga njësitë e vetëqeverisjes vendore .

Në nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar (në vijim referuar si “Ligji 139/2015”), përcaktohet se: *“Njësitë e vetëqeverisjes bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra”*.

Sipas nenit 24 të Ligjit 139/2015 të ndryshuar, njësitë e qeverisjeve vendore ushtrojnë funksionet e tyre në fushën e shërbimeve sociale. Njësitë e qeverisjeve vendore janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve nëpërmjet *“... krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj...”* si dhe nëpërmjet *“... krijimit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”*.

Në nenin 54 të Ligjit 139/2015, të ndryshuar, ndër të tjera, përcaktohet se është kompetencë e Këshillit Bashkiak të miratojë normat, standardet dhe kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik.

Referuar nenit 36 të ligjit 22/2018, subvencionimi i qirasë për banesat bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me miratimin e këshillave të njësisë të vetëqeverisjes vendore të veta, kur nuk kanë fond të lirë banesash sociale me qira, si rregull kur:

- a) nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg;
- b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave;
- c) familja është në kushtet e emergjencës për strehim dhe kur nuk përfiton nga një program tjetër.

Pra, miratimi dhe financimi i programeve sociale nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore është konsideruar si një nga mënyrat alternative për të integruar dhe fuqizuar politikat e mbështetjes sociale të hartuara në nivel qeverisje qendrore.

Sipas nenit 33 të ligjit 22/2018, përcaktohet se masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë, dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve sociale propozon miratimin e udhëzuesit operacional në kuadër të programit të subvencionit të qirasë.

2.2 Për efekt të zbatimit të këtij programi , këto terma kanë kuptimin si më poshtë:

- (i) “Familje” do të konsiderohet njësia shoqërore e përbërë nga dy ose me shume persona të cilët kane midis tyre lidhje martesore, gjaku ose birësimi dhe ato të kujdestarisë që jetojnë në të njëjtën strehë.
- (ii) “Individë” do të konsiderohet një person që sipas statusit të çertifikatës së gjendjes familiare në datën e aplikimit rezulton të jetë Kryefamiliar i vetëm.
- (iii) “Të Ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin
- (iv) me aftësi të kufizuar, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen të ardhura nga ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, përfitimet e personave me aftësi të kufizuara, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, nga ndihma ekonomike për shkak të aftësisë së kufizuar, e parashikuar në ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në republikën e shqipërisë”, në ligjin nr. 8098 datë 28.3.1996, “për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8626 datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik”, të ndryshuar; nga rimbursimi i shpenzimeve për energji elektrike; nga rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe nga paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar.
- (v) “Të ardhura mesatare” është niveli mesatar i konsumit familjar, sipas nivelit më të ulët territorial të disagregimit të të dhënave nga INSTAT-i dhe që publikohet në mënyrë periodike.
- (vi) 2 “Qira sociale” është qiraja me të cilën jepen banesat sociale me qira dhe që llogaritet, në çdo rast, me një kosto më të ulët sesa qiraja reale.
- (vii) Vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion.
- (viii) Qiraja mesatare është mesatarja e ofertave të qirasë së marrë në tregun e lirë gjatë një viti .
- (ix) “Zhvendosje” është largimi i përhershëm ose i përkohshëm, me ose kundër vullnetit të individëve, familjeve dhe/ose komuniteteve nga banesat, ndërtimet formale ose strukturat që nuk klasifikohen si banesë dhe/ose nga tokat që ata posedojnë, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, mbështetur në konsultim me subjektet e prekura, në ofrimin e strehimit alternativ, të përshtatshëm e efektiv, si dhe në garantimin e mbrojtjes ligjore efektive.

2.3. Të dhëna ndër vite mbi familjet përfituese të Bonusit të strehimit

Më poshtë po paraqesim të dhënat statistikore të nxjerra nga Drejtoria e Strehimit Social, mbi numrin e familjeve përfituese të bonusit të strehimit të miratuar me vendime të këshillit bashkiak, ndër vite si më poshtë vijon:

Nr.	Detajimi i VKB-ve	Nr. i Përfituesve sipas VKB	Shuma/Muaj
1	VKB Nr. 74, datë 27.12.2007	28	169,943.0
2	VKB Nr. 52, datë 19.12.2008	36	254 744
3	VKB Nr. 26, datë 17.07.2008	25	186,000.0
4	VKB Nr. 24, datë 26.10.2009	31	220,300.0
5	VKB Nr. 8, datë 15.01.2010	20	126138
6	VKB Nr. 58, datë 24.12.2012	29	241784
7	VKB Nr. 12, datë 28.02.2013	8	86330

8	VKB Nr. 39, datë 18.11.2013	32	308,874.0
9	VKB Nr. 47, datë 18.12.2013	6	61,141.0
10	VKB Nr. 14, datë 06.03.2015	14	118 493
11	VKB Nr. 27, datë 23.05.2016	54	463 166
12	VKB Nr. 65, datë 07.10.2016	59	748 684
13	VKB Nr. 89, datë 29.12.2016	156	1620760
14	VKB Nr. 43, datë 06.07.2016	48	517 346
15	VKB Nr. 39, datë 05.04.2017	99	972 577
16	VKB Nr. 52, datë 06.06.2017	60	697 226
17	VKB Nr. 107, datë 28.09.2017	45	563 149
18	VKB Nr. 127, datë 23.11.2017	28	350 994
19	VKB Nr. 27, datë 29.03.2018	57	58 9960
20	VKB Nr. 66, datë 07.06.2018	105	10 66953
21	VKM Nr. 127, datë 15.11.2018	83	1.138 023
22	VKM Nr. 151, datë 21.12.2018	30	248 035
23	VKM Nr. 7, datë 31.01.2019	27	260 351
24	VKM Nr. 30, datë 03.05.2019	100	1185298
25	VKM Nr. 63, datë 07.06.2019	23	249783
26	VKM Nr. 118 datë 25.10.2019	38	225355
27	VKM Nr. 126 datë 26.11.2019	124	1187484

Pse një Udhëzues për Subvencionin e Qirasë

Nisur nga problematikat e ndryshme social- ekonomike dhe arsyet e cituara më poshtë:

- Unifikimi i procedurave që do të ndiqen midis strukturave të Bashkisë Tiranë, me qëllim krijimin e lehtësirave të nevojshme për aplikimin në këtë program social strehimi.
- Përshtatje me ndryshimet e reja ligjore, dhe vënia në zbatim e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë auditimit.
- Numri i madh i aplikimeve për bonus strehimi, të cilat, tashmë, si rezultat i miratimit dhe zbatimit të reformës administrativo-territoriale, dërgohen edhe nga njësitë e reja administrative të Bashkisë Tiranë.
- Afati i gjatë kohor në skemën e përfitimit të bonusit të strehimit të familjeve përfituese ndër vite, duke filluar nga viti 2008.
- Domosdoshëria e vlerësimit social-ekonomik paraprak të familjeve të cilat aplikojnë për t'u trajtuar me subvencionim të qirasë

Për sa më sipër, Drejtorisë së Strehimit Social i lindi nevoja të hartojë një udhëzues për mënyrën e funksionimit të përfitimit të subvencionimit të qirasë

2.4. Administrimi dhe masa e subvencionit të qirasë së banesës.

Subvencioni i qirasë iu shpërndahet me vendim të Këshillit Bashkiak, atyre familjeve të cilat kanë paraqitur kërkesën për strehim duke plotësuar formularin tip të strehimit dhe që përfitojnë pikët maksimale, sipas sistemit të pikëzimit të miratuar për këtë program sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 1 - Formula e Pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social “Subvencioni qirasë”

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	18
A	Nuk disponon apartament në pronësi	4
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore	2
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	2
Ç	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor	4
D	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	6
1.2	KUSHTET FAMILJARE	30
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë ku përfshihen dhe vajzat nëna	6
B	Përbëhen nga familje që kanë në ngarkim persona me aftësi të kufizuar apo persona në pension .	5
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë	4
Ç	Cifte të reja/të rinj me moshë jo më të madhe se 35 vjeç Familje të reja ku çifti bashkëshortëve ka moshe të përbashkët totale deri 60 vjeç.	15
1.3	KUSHTET SOCIALE	40
A	Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç	6
B	Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirit të banesës ish-pronarëve	5
C	Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant /Azilkerkues	1
Ç	Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë	4
D	Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) /Punonjës i RENEA-s /Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi...	2
DH	Viktimë e dhunës në familje/Viktimë e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit	8
E	Anëtar i minoritetit rom /egjiptian	8
F	I mitur në konflikt me ligjin	1
G	Komuniteti LGBTI	3
GJ	Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike	2
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	12
A	Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare	5

B	Të ardhura deri 70% - 100% të të ardhurave mesatare	4
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare	3

Në llogaritjen e pikëve për individët/familjet aplikuese, Komisioni i Strehimit duhet të marrë në konsideratë rregullat e mëposhtme:

Pikët maksimale që mund të përfitojë një individ/familje janë 100. Nuk mund të mbledhen brenda për brenda një kriteri pikët:

1. Nga A deri në Ç të kriterit 1.1 - Kushtet e strehimit;
2. Nga A deri në Ç të kriterit 1.2 - Kushtet familjare; dhe
3. Nga A deri në C të kriterit 1.4 - Kushtet ekonomike.

Pikët të kriterit 1.3 mund të mbledhen me njëra-tjetrën sipas rasteve më poshtë:

- a) Pika A mund të mbledhet me njërin prej rasteve si më poshtë:
- b) Me pikat B dhe Ç së bashku ose veçmas;
- c) Vetëm me pikën C;
- d) Vetëm me pikën D.

Pika B mund të mbledhet vetëm me pikën A.

Pika Ç mund të mbledhet me pikat A e B së bashku ose me njërin prej tyre. Në total mbledhja e pikëve A, B e Ç nuk duhet të rezultojë më e lartë se 20 pikë.

Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit, por pa u kufizuar në to, kanë kategoritë e përcaktuara në ligjin 22/2018 “Për strehimin social” përfshirë dhe individët që dalin nga sistemi i përkujdesjes alternative si më poshtë:

- a) individët me statusin e jetimit;
- b) personat me aftësi të kufizuara;
- c) të moshuarit;
- ç) invalidët e punës;
- d) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- dh) emigrantët e rikthyer;
- e) punëtori emigrant;
- ë) azilkërkuesit;
- f) familjet e komunitetit rom;
- g) familjet e komunitetit egjiptian;
- gj) Viktimat e dhunës në familje;
- h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
- i) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë;
- j) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individi nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji;
- k) të miturit, 14–18 vjeç, dhe të rinjtë, 18–21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri;
- l) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara; ll) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012.
- ll) familjet me statusin e qiranarrësit në banesa ish-pronë private sipas aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.3, datë 1.03.2012.

Gjithashtu në mbështetje të nenit 6, të ligjit nr .22/2018, “Për strehimin social”, si dhe vendimit nr. 361 datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së familjeve/ individëve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara

në ligj dhe të bashkëpunimit institucional”, parashikohet procedura e zhvendosjes së individëve/familjeve si dhe trajtimin e tyre me subvencion të qirasë .

Referuar nenit 6 të ligjit nr .22/2018, “Për strehimin social” parashikohet qartë se në rast se qëndrimi në një vendbanim ose strehim bëhet i pamundur, për shkak të investimeve me interes publik, prishje të objektit për shkak të përjashtimit nga procesi i legalizimit ose raste të tjera, të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera njësia e vetëqeverisjes vendore ndër të tjera,informon individin/familjen për mundësitë alternative të strehimit. Zhvendosja nuk zbatohet pa siguruar më parë sistemimin me strehim të individëve/familjeve që zhvendosen dhe nuk përfitojnë shpronësim.

Pika 1.6 e VKM 361 datë 29.05.2019 “ Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së familjeve/ individëve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj dhe të bashkëpunimit institucional” ka parashikuar Individ/familja, ndaj të cilit/sëcilës fillon procesi administrativ i zhvendosjes, nuk duhet të mbetet i/e pastrehë ose të vihet në një situatë që e bën atë vulnerabël ndaj shkeljes së të drejtave të tjera të njeriut.

Njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vlerën konkrete të subvencionit të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social në tregun e lirë, bazuar në:

- a) vlerën mesatare të qirasë në tregun e lirë, e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane e rurale të një njësie të vetëqeverisjes vendore;
- b) të ardhurat familjare, sipas kategorizimit të pikës 44, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018;
- c) aftësinë e familjes për të përballuar pagesat mujore të qirasë, sipas përcaktimeve të nenit 3, të ligjit nr. 22/2018.

Masa e subvencionit të qirasë për çdo individ/familje llogaritet si diferenca midis qirasë reale që paguan familja dhe aftësisë së vetë familjes/individit për të përballuar pagimin e qirasë, e cila llogaritet për 12 muajt e fundit. Qiraja reale nuk mund të jetë më e lartë se qiraja mesatare sipas shkronjës (a) të pikës 3 të vendimit nr. 362/2019 të Këshillit të Ministrave.

Që një familje/individ të përfitojë subvencionimin e qirasë duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në njërin prej rasteve të shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", dhe të mos ketë të ardhura më të larta se ato të përcaktuara në nenin 20, të tij.

Pagesa e subvencionit të qirasë i referohet nivelit të të ardhurave mujore të familjes dhe qirasë për të cilën është lidhur kontrata e qirasë. Kontrata e qirasë lidhet ndërmjet pronarit ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij dhe, sipas rastit, individit përfitues ose, në rastin e familjeve, prej bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, në bazë të dispozitave të Kodit Civil.

Shuma e vlerës së subvencionimit të qirasë llogaritet sipas formulës:

Formula e përgjithshme e llogaritjes së vlerës së subvencionimit të qirasë është:

$$S = Qr - A \times Ap \text{ ku } Qr \leq Qm$$

- a- S është vlera e subvencionit;
- b- A janë të ardhurat e familjes;
- c- Ap është aftësia përballuese e familjes, sipas nenit 3 të ligjit nr. 22/2018
- ç- Qm është vlera mesatare e qirave të banesave në tregun e lirë, sipas pikës 36 të nenit 2 të këtij ligji;
- d- Qr është qiraja reale e përcaktuar në pikën 35 të nenit 2 të ligjit 22/2018.

Vlera e subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për një njesi të qeverisjes vendore të caktuar luhetet nga 0 deri në 100%, në varësi të të ardhurave të familjes. Për një vlerë qiraje Qr, vlerat

maksimale dhe minimale të subvencionimit të strehimit, në varësi të të ardhurave të familjes llogariten sipas formulës së mësipërme.

Subvencioni i qirasë rinovohet çdo vit, sipas kontratës së qirasë dhe të ardhurave të deklaruara të familjes, sipas përcaktimeve në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 29, të ligjit 22/2018 “Për strehimin social”.

Afati i lidhjes së kontratës së qirasë nuk mund të jetë më i shkurtër se 1 vit.

Në rastet kur subjekti përfitues nuk e depoziton kontratën brenda afatit 1-mujor, komisioni shtyn afatin me 30 ditë. Nëse edhe pas këtij afati shtesë subjekti përfitues nuk depoziton kontratën, ai humbet të drejtën për të vijuar procedurën. Subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Familja që ka përfituar subvencionin e qirasë mund të dalë nga kjo skemë pas një viti, nëse vërtetohet që ajo ka zgjidhur problemin e strehimit, ose nëse të ardhurat e familjes janë rritur mjaftueshëm për të përballuar pagesën e qirasë pa nevojën e bonusit, dhe skualifikohen sipas metodikës së përlogaritjes së qirasë.

Çdo familje e cila është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, pajiset me një skedë personale, e cila do të përmbajë:

- a) të dhëna mbi identifikimin e qiramarrësit;
- b) të dhëna mbi identifikimin e qiradhënësit;
- c) adresën e banimit aktual të qiramarrësit;
- d) adresën e banesës që jepet me qira;
- e) adresën e banimit të qiradhënësit, nr.telefoni apo çdo të dhënë tjetër që mund të shërbejë për të komunikuar me të në rast ndërprerje të bonusit;
- f) të dhëna të mjaftueshme për të kontaktuar me qiramarrësin;
- g) shumën e bonusit që përfiton qiramarrësi në muaj;
- h) vitin apo periudhën gjatë të cilit është i vlefshëm bonusi;
- i) masa sigurie, në mënyrë që të mos lejojë falsifikimin e tij.

PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË

Proçesi i funksionimit të subvencionit të qirasë, ndjek hapat dhe procedurat si më poshtë:

1. Faza e Parë e aplikimit

1. Plotësimi i formularit për aplikim pranë Njësive Administrative/Lagjeve dhe depozitimi i tyre në Bashkinë Tiranë.

Çdo aplikant, i cili kërkon të trajtohet me subvencionin e qirasë duhet të drejtohet pranë zyrës së urbanistikës në njësinë administrative për të plotësuar **formularin e strehimit tip**, për subvencionin e qirasë. Çdo individ/familjeje që paraqet kërkesën, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, nëse ka të tilla, sipas formatit që i bashkëlidhet këtij vendimi, të emërtuar si Aneksi 6

Formularit të strehimit duhet t'i bashkëlidhen dhe dokumentat e mëposhtëm:

- Deklaratën e vërtetësisë së informacionit të pasqyruar në formularin e strehimit, me anë të së cilës aplikuesit i bëhen të njohura edhe përgjegjësitë ligjore që ai ka në lidhje me dhënien e një informacioni dhe fakteve të rreme, sipas Aneksi 5 pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi;
- Kopjen e kartës së identitetit të aplikuesit;

- Çertifikatën familjare.
- Vleresimin social ekonomik
- Kontratë qiraje e nënshkruar nga të dy bashkëshortët/bashkëjetuesit dhe numër llogarie të qiradhënësit/pronarit social
- Vërtetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës sipas Aneksi 6

2. Pas plotësimit të formularit dhe dokumentacionit si më lart, Njësitë Administrative/Lagjet përkatëse i përcjellin në Bashkinë Tiranë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social.

Drejtoria e Strehimit Social pret kërkesat për aplikim (FS) nga njësitë administrative, të cilat duhet të jenë të protokolluar nga Bashkia Tiranë, nga datat 1 deri më datë 10 të çdo muaji. Kur dita e fundit e këtij afati bie ditë e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

Ndërkohë qytetarët e interesuar për këtë program mund të drejtohen pranë njësisë administrative në çdo kohë, përjashtim bëhet për rastet e emrgjencës të cilët paraqesin kërkesën në NJA në çdo kohe, dhe depozitimi i rastit bëhet menjëherë.

Përjashtimisht, për rastet kur Formularët e Strehimit të cilët protokollohen pas datës 10 të çdo muaji, do të meren në shqyrtim nga Drejtoria e Strehimit Social në muajin pasardhës.

3. Seleksionimi i kërkesave nga Drejtoria e Strehimit Social

Drejtoria e Strehimit Social, realizon procesin e seleksionimit të formularëve të vlefshëm sipas akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e strehimit social.

Pas seleksionimit bëhet regjistrimi i tyre në sistemin elektronik të drejtorisë dhe harton listën paraprake të familjeve të cilat në bazë të të dhënave të plotësuara në FS dhe mbështetur në vetëdeklarimin e aplikuesit, ku rezulton se ata plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2, 3 e 4, të nenit 13, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

Në qoftë se kërkesa e aplikantit ka të meta dhe mangësi të të dhënave të kërkuara nga ky vendim, struktura përgjegjëse për strehimin, brenda 7 ditëve pune nga dita e regjistrimit të kërkesës, njofton aplikantin/kërkuesin për pasaktësitë, dhe i kërkon me shkrim aplikantit t'i korrigjojë ato. Kur kërkuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet aplikantit.

Drejtoria e Strehimit Social, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë dhe Njësitë Administrative, brenda 7 shtatë ditëve kalendarike nga momenti i depozitimit të Formularëve nga Njësitë Administrative, njofton aplikuesit që përmbushin kriteret për të përfituar subvencionimin e qirasë, si dhe ato që nuk mund të përfitojnë.

DSS do të njoftojë çdo familje e cila nuk shpallet përfituese e fazës së parë, përmes shkresë zyrtare duke sqaruar arsyen e mos shpalljes fitues.

Njoftimi (shkresa) do t'i drejtohet njësisë administrative ku aplikuesi ka realizuar plotësimin e formularit, duke vendosur në dijeni edhe qytetarin që ka aplikuar.

Familjet që rezultojnë të sukseshme në fazën e parë të aplikimit, brenda 15 (pesmbëdhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit, dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton deklarimin dhe vërtetësinë e plotësimit të formularit, në bazë të të cilit janë përzgjedhur fitues.

2. Faza e dytë e aplikimit:

1. Familjet që rezultojnë të sukseshme në fazën e parë të aplikimit, brenda 15 (pesmbëdhjetë) ditëve nga momenti i njoftimit nga Drejtoria e Strehimit, paraqesin pranë Zyrës së Pritjes me Qytetarin në Bashki Tiranë dhe dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimin nr. 384 date 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëvetëqeverisjes vendore”, si më poshtë:

a. Për të dhëna personale të aplikantit:

- i. çertifikata e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
- ii. vërtetimi për vendbanimin në njësinë e vetqeverisjes vendore ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

b. Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës (a) të nenit 16 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”:

- i. vërtetimi nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes;
- ii. vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit;
- iii. vërtetimi nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- iv. akt verifikimi nga njësi vendore për:
 - banesat në rrezik shembje;
 - rastet kur familja ka mbetur e pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore;
 - banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit;
- v. vendimin e gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;

c. Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës (b) të nenit 16:

- i. Çertifikatë familjare;
- ii. vendimi i gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara;

d. Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës (c) të nenit 16:

- i. vërtetimi i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara;
- ii. vërtetimi përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- iii. dokumentin që vërteton se ka ngelur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave të ish-pronarëve;
- iv. dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";
- v. dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Policisë së Burgjeve;
- vi. dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje;
- vii. vetëdeklarimin nëse individi/familja i përket komunitetit Rom ose Egjiptian;
- viii. dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin
- ix. vetëdeklarimin se i përket grupimit LGBTI, dhe

x. vërtetimin me çertifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë nënë;

e. Për vërtetimin e kushteve ekonomike sipas shkronjës (ç) të nenit 16:

- i. vërtetimi i të ardhurave neto të familjes, kur kjo është e mundur, ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, bashkëlidhur dokumente zyrtare që e vërtetojnë këtë, nëse ka përfshirë vërtetim nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit dhe të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- ii. dokumenti nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- iii. vërtetimi nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar;
- iv. vërtetimi nga zyra e punësimit e njësive vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;
- v. vërtetimi nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Ndër të tjera për të vërtetuar situata të caktuara është e nevojshme përpos listës së mësipërme të paraqiten edhe dokumenta si më poshtë vijon:

1. Vërtetimi nga zyra përmbartimore për masën e pensionit ushqimor që përfiton sipas vendimit të gjykatës.
2. Pasqyra financiare për vitin kalendarik të shkuar për personat e vetëpunësuar e njehsuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore. Ekstrakt historik nga QKB.
3. Vërtetimi nga zyra e punësimit e njësive vendore përkatëse për personat të cilët janë regjistruar si persona punëkërkues të papunë;

Dokumentacioni i parashikuar në shkronjën (d), pika (vii), (ix) dhe (x), si dhe shkronjën (e) të pikës 17 të vendimit 384/2019 dorëzohet nga vetë aplikanti. Dokumentacioni tjetër i parashikuar në pikën 17 të këtij vendimi, që mbajnë apo përgatisin organet publike në vend, sigurohet nga Njësitë Administrative përkatëse duke përjashtuar aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre, vetëm nëse aplikanti depoziton deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve të lidhura me të, sipas formatit tip që i bashkëlidhet këtij vendimi si Aneksi 7.

Nëse aplikanti nuk e dorëzon apo refuzon të firmosë këtë deklaratë, Njësia Administrative/Lagjet shkarkohen nga detyrimi i mbledhjes së dokumentacionit dhe ky detyrim i kalon vetë aplikantit.

Dorëzimi i dokumentacionit nga vetë aplikanti në rastet kur nuk kanë plotësuar deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e dokumentacionit, do të realizohet pranë Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët. Në rast se dita e fundit e këtij afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

Çdo praktikë e dorëzuar do të shoqërohet me inventarin e dokumentacionit të dorëzuar e firmosur nga personi përgjegjës i cili pranon dokumentat si dhe aplikanti. Çdo praktikë duhet të përmbajë të gjitha dokumentat sipas përbërjes familjare të aplikuesit, në rastin kur dokumentacioni nuk rezulton i plotë pas vlerësimit nga DSS bën njofton Njësia Administrative përkatëse dhe aplikuesin për mungesat në dokumentacion.

Për efekt të zbatimit të këtij udhëzuesi, do të konsiderohen të vlefshme dokumentet që janë lëshuar nga institucionet kompetente, jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e përcaktuar për mbledhjen e Komisionit të Strehimit.

2. Seleksionimi i formularëve dhe dokumentacionit

Drejtoria e Strehimit Social seleksionon dhe vlerëson paraprakisht dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit, brenda 10 dhjetë ditëve kalendarike.

3. Shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit nga Komisioni i Strehimit

Drejtoria e Strehimit Social vendos në dispozicion të Komisionit të Strehimit të gjithë formularët e seleksionuar si të vlefshëm gjatë fazës së parë të shqyrtimit, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit.

Çdo formulari do t'i bashkëlidhet edhe "Lista e inventarit" (bashkëlidhur këtij udhëzuesi si Aneksi nr. III, i cili përmban të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit dhe i nënshkruar nga nëpunësit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.

Komisioni i Strehimit mblidhet në datën e caktuar në njoftimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, por jo më pak se 1 (një) herë në 2 (muaj).

Drejtoria e Strehimit Social njofton Komisionin e Strehimit për mbledhjen e radhës e cila nuk duhet të jetë më vonë se data 15 e muajit pasardhës, duke i vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi, së bashku me Formularin e Strehimit.

4. Shpallja e listës përfituese nga Komisioni i Strehimit

Pas marrjes në dorëzim të listës së inventarit, Komisioni i Strehimit, në bazë të dokumentacionit të dërguar nga aplikuesit dhe kritereve për përzgjedhjen e përfituesve, harton listën e familjeve fituese dhe jo fituese, duke saktësuar rekomandimet përkatëse për çdo aplikim, i cili rezulton me mungesa në dokumentacion.

Komisioni i Strehimit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij asistohet nga një nëpunës i caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale.

Procesi i përzgjedhjes finalizohet me zbardhjen e procesverbalit përkatës, pjesë e të cilit është edhe lista përfundimtare e aplikantëve dhe përfituesve. Komisioni i Strehimit i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, procesverbalin së bashku me listën përfundimtare të përfituesve.

5. Njoftimi i aplikantëve që nuk rezultojnë përfitues të subvencionit të qirasë

Drejtoria e Strehimit Social, brenda 10 ditëve nga data e miratimit të listës së përfituesve nga Këshilli Bashkiak t, njofton përmes shkresave zyrtare çdo aplikues, i cili në bazë të vlerësimit të kryer nga Komisioni i Strehimit, nuk rezulton fitues në këtë program social strehimi, duke i arsyetuar edhe shkaqet e mospërzgjedhjes së tyre.

Aplikantët jofitues kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre pranë Kryetarit të Bashkisë/ strukturës përgjegjëse për ankimim brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit ose pranë Gjykatës që ka për kompetencë shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve.

6. Miratimi i listave përfundimtare në Këshillin Bashkiak

Mbi bazën e procesverbalit të Komisionit të Strehimit, në të cilin mund të jenë pasqyruar edhe rekomandime/detyra të lëna për Drejtorinë e Strehimit për aplikues të caktuar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, brenda 3 ditëve nga zbardhja e procesverbalit, harton dhe përgatit relacionin dhe projekt-vendimin për miratimin e listës përfituese, në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak.

8. Publikimi i listës përfituese

Drejtoria e Strehimit Social në bashkëpunim me Drejtorinë e Komunikimit me Qytetarët bën publike listën përfundimtare të përfituesve të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

Drejtoria e Strehimit Social përgatit listën dhe pagesën e përfituesve me vlerën përkatëse me numrat e llogarive bankare, shoqëruar me shkresën përcjellëse me relacionin përkatës. Pas kontrollit financiar të dokumentacionit Drejtoria e Financës fillon procedurën e shpërndarjes së pagesës së bonusit të strehimit.

Brenda një muaji nga data e miratimit nga komisioni i strehimit të njësisë së vetëqeverisjes vendore të listës së individëve/familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë së banesave në treg të lirë, subjekti përfitues depoziton pranë komisionit të strehimit kontratat e qirasë të lidhura ndërmjet tij dhe pronarit social.

Në rastet kur subjekti përfitues nuk e depoziton kontratën brenda afatit 1-mujor, komisioni shtyn afatin me 30 ditë. Nëse edhe pas këtij afati shtesë subjekti përfitues nuk depoziton kontratën, ai humbet të drejtën për të vijuar procedurën. Subjekti ka të drejtë të aplikojë përsëri në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Vënia në zbatim e këtij udhëzuesi të përfitimit të bonusit të strehimit, do të udhëhiqet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, në bashkëpunim me strukturat e listuara si më poshtë vijon:

- 24-Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë/dhe 3 Lagjet
- Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar
- Drejtorinë e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit
- Drejtorinë e Përgjithshme të Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun

9. Për çështje specifike të cilat nuk janë trajtuar në këtë udhëzues operacional standart, do të jenë të zbatueshme parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore, në fushën e Strehimit Social.

10. Shtrirja Gjeografike

Programi synon të përfshijë dhe mbështesë të gjithë individët dhe familjet që individët dhe familjet që kanë vendbanim në territorin e Bashkisë Tiranë.

11. Anekset

Anekset e listuara në vijimi i bashkëlidhen Udhëzuesit Operacional dhe konsiderohen pjesë përbërëse e tij:

Aneski I: Format Tip i Aktit të Verifikimit në Banesë;

Aneksi II: Format i Tip i Vlerësimit Social-Ekonomik;

Aneksi III: Listë /Inventarë (profili dosjes)';

Aneksi IV: Formular tip strehimi;

Aneksi V: Format i vërtetësisë së informacionit paraprak;

Aneksi V1: Vertetim qe konfirmon regjistrimin e kërkesës sipas shtojcës c të VKM 384/2019;

Aneksi V11 :Deklarate per dhenien e pëlqimit për lejen për marrjen e dokumentacionit për fazen e dyte te aplikimit.

ANEKSI I

Format Tip i Aktit të Verifikimit në Banesë

AKT – KONSTATIMI

Sot më datë / / 2020, grupi i verifikimit të banesave ku jetojnë qytetarë të cilët kanë aplikuar për të qenë përfitues të bonusit të strehimit në bazë të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” pasi verifikoi gjendjen faktike konstatoi se:

Qytetari _____banues në adresë _____

Banon

Nuk banon

Në adresën e specifikuar në kontratën e qirasë me nr. _____ , datë _____

Disponon

Nuk disponon

Shënim: _____

Përfituesi i Bonusit:Z//Znj._____

Znj. Anëtar komisioni Nënshkrimi _____

Znj. Anëtar Komisioni Nënshkrimi _____

Z. Anëtar Komisioni Nënshkrimi _____

Ky Akt-Konstatimi u përpilua në 2(dy) kopje, një kopje i jepet qytetarit dhe një kopje mbahet nga Drejtoria e Strehimit Social.

ANEKSI II

Formati Tip i Vlerësimit Social-Ekonomik

Formular për vlerësim social –ekonomik	
• INFORMACION BAZË PËR PËRFITUESIN	
Data e plotësimit të formularit:	
A1. Emri Mbiemri i rastit që referohet:	A8.Statusi Civil

A2.Data e lindjes: A3.Gjinia(M/F):	Mosha	A9.Profesioni
A4. Vendlindja/Vendbanimi (fshati/qyteti)		A10.Nr. i fëmijëve
A5. Origjina etnike (Rom/Egjiptian/Mix)		A11.Adresa ku banon
A6. Përfituesi jeton me		A12.Persona me aftësi të kufizuar
A7. Nr. i kontratës së banesës me qira		A13.Telefoni:
B. INFORMACION PËR KUSHTET SOCIAL EKONOMIKE TË PËRFITUESIT (Rrethoni alternativat te cilat I pershtaten familjes)		
<ul style="list-style-type: none"> - Familje gjithsej me 1 anëtar - Familje gjithsej me 2 anëtar - Familje gjithsej me 3 anëtar - Familje gjithsej me 4 anëtar - Familje gjithsej me 5 anëtar - Familje gjithsej me 6 anëtar - Familje që kanë në përbërje - Familje që kanë në përbërje ROM - Kryefamiljare gra - Jetim deri në 18 vjec - Jetim deri 25 vjec 25 - Trinjakë - Katërnjakë - Pesënjakë - Viktimat e dhunës - Viktima të trafikimit - Fëmijë normal me shërbim kujdestarie - Fëmijë AK me shërbim kujdestarie - Familjeve në ndihmë ekonomike - Familjeve me anëtarë me PAK 		
<p>B1. Ambienti ku jeton përfituesi: (Përshkruaj me detaje ambientin ku jeton personi i identifikuar, shtëpinë sa dhoma ka, tualeti, korridori, sa katëshe është banesa me çfarë materiali është ndëtuar shtëpia, ka apo jo hapësira të mjaftueshme, kushtet higjieno-sanitare ose shkruaj çdo gjë tjetër që të jep mundësinë e përfytyrimit real të shtëpisë)</p>		
<p>B2. Gjendja financiare, të ardhurat mujore, me çfarë jeton përfituesi.(Përshkruaj se kush janë ardhurat ekonomike të përfituesit së bashku me familjarët e tjerë)</p> <p>a.Ndihmë ekonomike lek b. KEMP lek c.pensione lek d. të ardhura të tjera lek</p> <p>Totali në lek i të ardhurave</p>		
<p>B3. Gjendja shëndetësore e përfituesit .(Përshkruaj si është gjendja shëndetësore, fizike, mendore e përfituesit dhe shkurtimisht gjendjen shëndetësore të familjarëve të tij</p>		

B4. Familje që nuk përballon pagesën e qirasë, përshkruaj arsyet:

B5. Komente nga punonjësi që bën vlerësimin:

Nënshkrimi i Familjarit:

Emri i Punonjësit:

Aneksi III

Profil aplikimi per programin e Bonusit te Qirase

Emri	
Atësia	
Mbiemri	
Vendlindja	
Ditëlindja	
Gjendja civile	
Vendbanimi	
Kombësia	
Status i veçantë	
Të ardhurat e familjes	
Vlera e Qirasë që paguan	
Masa e bonusit që përfiton	... lekë në muaj sipas formuleve në ligjit $S = Qr - AxAp$ ku $Qr < /\text{ë} Qm$
Masa e bonusit sipas zonës	
Vlera e qirase që propozohet	

Profil i aplikuesit

(Shpjego me fjale kush eshte perfituesi, moshen, historikun nese eshte perserites ose jo dhe arsyet perse eshte trajtuar me pare. Statusin e vecant nese ka. Ne rast se nuk ka nje status te vecante shpjego arsyet qe e nxiten te aplikojte per bonusin e qirase. Marredhenia me pronarin social)

Norma e strehimit

Aplikuesi	Nr. i anetareve te familjes	Norma minimale e strehimit	Normat e strehimit sipas kontrates

Inventari i Dokumentacionit

Ne baze te ligjit ligjit Nr .9232, datë 13.05.2004, për “Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (i ndryshuar); VKM Nr. 574, datë 29.8.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t`u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; Udhëzimit Nr. 23, datë 30.12.2008 për “Përmbajtjen e bonusit të strehimit” dhe Udhëzuesin Operacional të miratuar me VKB nr. 91 Datë 26.07.2018 kemi pranuar me shkresen nr.... te ardhur ne Bashkine Tirane me dt... dhe deleguar Drejtorise së Strehimit me datë....

Nr. Rendor	Emertimi i Shkreses	Nr. prot per dokumentin	Nr. i fleteve	Nr. progresim
	Njësia Administrative			

	Formulari Strehimit			
	Kërkesë BT			
	Kontratë qiraje			
	Deklaratë legalizimi			
	Vërtetim banimi			
	Fotokopje I.D -CARD			
	ZVRPP			
	ZRVPP - Origjine			
	Vërtetim tatime			
	Derdhje kontributesh			
	Karton punëkërkuesi			
	Vërtetim page			
	Akt-Konstatimi			
	Totali			

Pas vlerësimit paraprak, paraqes aplikimin për shqyrtim të mëtejshëm ne Komisionin e Strehimit.

Specialist
Emer Mbiemer

Miratoi
Drejtori i Drejtorise
Emer Mbiemer

ANEKSI 7

**DEKLARATË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LEJEN PËR MARRJEN E
DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË APLIKIMIT**

DEKLARATË

PËR

**DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE, AKSESIN PËR NJOHJEN
DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Unë _____, i biri i/e bija e _____ dhe i/e _____, lindur më _____, në _____, dhe banues/banuese në _____, me shtetësi _____, me numër identifikimi _____, me vullnetin tim të lirë,

D E K L A R O J S E:

Mbështetur dhe në zbatim të:

- Pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;
- pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”;
- të neneve 2, 5 e 10, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

	Deklarimi	Firma (në kutinë që aplikanti dëshiron të plotësojë)
	<p>- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave.</p> <p>- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</p> <p>- Jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve social të strehimit të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social.</p>	
	<p>- Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave;</p> <p>- Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</p> <p>- Nuk jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura, në referim të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve sociale të strehimit të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”.</p>	

_____, më ____ . ____ .20 ____

E S I

D E K L A R U

(_____)

ANEKSI 5

DEKLARATË E VËRTETËSISË SË INFORMACIONIT PARAPRAK

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj sa më poshtë:

1. I gjithë informacioni i dhënë në formularin KËRKESË PËR TRAJTIM ME STREHIM është i vërtetë.
2. Pranoj që, në rast se përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, të bëhet inspektimi në banesën ku banoj dhe verifikimi i të gjithë informacionit të dhënë.
3. Jam në dijeni se, për çdo informacion të rremë, mua dhe anëtarëve të familjes sime u hiqet e drejta për të përfituar strehim.
4. Jam në dijeni se, nëse përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, struktura përgjegjëse për strehimin në bashki, bazuar në të dhënat mbi të ardhurat familjare, mund të më ofrojë një formë tjetër strehimi nga ajo që kam kërkuar në KREUN IV të këtij formulari.

Nënshkruar në _____, më _____

Deklaruesi:

(Emër/Mbiemër/Firmë)

ANEKSI 4

KËRKESA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

KËRKESË

PËR T'U TRAJTUAR ME STREHIM, BAZUAR NË LIGJIN NR. 22/2018, "PËR STREHIMIN SOCIAL"

FAZA E PARË E APLIKIMIT

Mbiemri..... emri datëlindja

.....

Qyteti.....Njësia administrativeRruga

.....

PallShkAp.....(Në rastin e një banese private) Nr Tel

.....

I. GJENDJA FAMILJARE

MBIEMRI	EMRI	DATËLINDJA Dita/Muaji/Viti (00/00/0000)	(1) SE KSI	(2) GJEND JA CIVILE	Nr. DOKUMEN TI I IDENTIFIKIMIT	(3) FAMILJAR ËT	(4) PUNË SIMI

Në tabelë hidhen kodet, si më poshtë vijon:

1. SEKSI	2. GTENDTA CIVILE	3. FAMILTARËT	4. PUNËSIMI
Mashkull (M)	Beqar/e	1 Aplikanti	00 Punësuar në shtet
Femër (F)	i/e martuar	2 Nëna/Babai	01 Punësuar në privat
Nuk	i/e ve	3 Bashkëshorti/ia	02 I/E vetëpunësuar
Përgjigjem (N)	i/e divorcuar	4 I biri/E bii Gjysh/e	04 Punësim i rastit
			05 I përfshirë në programin e ndihmës ekonomike
		Nip/Mbesë	06 I përfshirë në programin e pagesës së papunësisë
		Vjehri/a	07 Të tjerë
		Dhëndri/nusia	08
		Vëllai/motra	09
		Kunati/a	10
		Të tjerë	11

Shënim: Në kolonat 1, 2, 3 e 4 vendos numrin që i korrespondon gjendjes suaj. Të dhënat e kolonës 3 duhet të korrespondojnë me certifikatën familjare.

II. KUSHTET E STREHIMIT

2. Disponon banesë në pronësi

Po

J

o

2.1. Nëse **PO**, jep informacionin e saktë për:

- Prona është e regjistruar në emër të (vendos referencën sipas kolonës 3, të tabelës “Gjendja familjare”) _____

- Prona ka një strukturë:

- garsoniere

- struktura e apartamentit 1 + 1

struktura e apartamentit 2+1

- struktura e apartamentit 3+1.....

- Sipërfaqja totale e banesës sipas dokumentit të pronësisë

- Sipërfaqja totale e banimit¹

2.2. Nëse jeni përgjigjur negativisht në pikën 2, vazhdoni me plotësimin e informacionit, si më poshtë vijon:

- Banoj me qira

- Banoj me prindërit

- Banoj në banesë informale

2.3 Banoj në banesë rrezik shembjeje

2.4 Banoj në banesë të mbipopulluar

2.5 Kam mbetur i pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore

2.6 Kam mbetur i pastrehë nga procese gjyqësore

2.7 Banoj në banesë që priset/përrjashtohet nga legalizimi

III. KUSHTET FAMILJARE

Shëno vetëm në një kuti që i përshtatet kushtit tuaj familjar

3.1 Familje një prindërore që kam në ngarkim fëmijë.....

- 3.2 I/E moshuar që kam mbushur moshën e pensionit dhe nuk jam përzgjedhur për t'u strehuar në një institucion publik të përkujdesjes shoqërore
- 3.3 Familje me më shumë se 4 fëmijë
- 3.4 Çift me moshë jo më të madhe se 70 vjeç

¹ Në sipërfaqen totale të banimit përfshihen sipërfaqja e dhomave të gjumit plus sipërfaqen e dhomës së ditës, të matura brenda mureve ndarëse.

IV. KUSHTET SOCIALE

Shëno në kutitë që u përshtaten kushteve tuaja sociale

- 4.1 Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara.....
- 4.2 Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç
- 4.3 Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimit të banesës ish-pronarëve
- 4.4 Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant
- 4.5. Azilkërkues
- 4.6 Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë
- 4.7 Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH)
- 4.8 Punonjës i RENEA-s a
- 4.9 Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri
- 4.10 Viktimë e dhunës në familje
- 4.11 Viktimë e trafikimit
- 4.12 Anëtar i minoritetit rom
- 4.13 Anëtar i minoritetit egjiptian.....
- 4.14 I mitur në konflikt me ligjin
- 4.15 Vajza-nëna
- 4.16 Komuniteti LGBTI
- 4.17 Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike

V. TË ARDHURAT E FAMILJES

1. Ky seksion duhet të plotësohet për çdo person që siguron një të ardhur në familje, në përputhje me kolonat 3 e 4, të tabelës “Gjendja familjare”. Në të ardhurat totale të familjes përfshihen të ardhurat neto nga punësimi, dypunësimi, pagesa e papunësisë, pagesa e ndihmës ekonomike, pensioni, dërgesa nga emigracioni, qira nga prona, transfertat të tjera nga të afërm, si dhe çdo lloj e ardhure tjetër që sigurohet mbi baza mujore ose vjetore nga trashëgimi, interesa bankarë etj. Me të ardhura neto kuptohen të ardhurat pas shlyerjes së detyrimeve, si: taksa, tatime e sigurime shoqërore.

- Të ardhurat totale mujore të familjes
- Të dhëna të detajuara të të ardhurave mujore të familjarëve, sipas kolonës 3, të tabelës “Gjendja familjare”
- 00 0408
- 01 05 09
- 02 06 10
- 03 07 11
- Të ardhura nga emigracioni (vjetore)
- Të ardhura nga qiraja (mujore)
- Të ardhura të tjera (vjetore)

FORMA E TRAJTIMIT SIPAS NJËRIT PREJ PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT

Unë dhe familja ime kërkojmë të trajtohem me strehim nëpërmjet programit të:

(Rendit nga 1 deri në 4, sipas preferencës: 1 për preferencën më të madhe; 4 për atë më të ulët)

b) Banesë sociale me qira

.....

- Përmirësimi i banesës

- Banesë me kosto të ulët

4. Tokë e pajisur me infrastrukturë për të ndërtuar vetë banesë

5.

Shënim: *Forma e përfitimit mund të ndryshojë nga ajo që ju keni cilësuar si më të*

preferuarën, në varësi të mundësive të zgjidhjes dhe aftësisë financiare të familjes suaj për të përballuar kostot.

Në mungesë të banesave sociale me qira dhe në mungesë të banesave me kosto të ulët, njësia e vetëqeverisjes vendore ofron një nga instrumentet e mëposhtme financiare. Nëse ju pranoni, duhet të shënoni:

Pranoj
Nuk/pranoj

Në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi qirasë në tregun e lirë

.....

Në mungesë të banesave me kosto të ulët, ofrohet, sipas mundësive buxhetore, subvencionimi i interesave të kredive....

ANEKSI 6

VËRTETIM QË KONFIRMON REGJISTRIMIN E KËRKESËS, OBJEKTIN E SAJ, DATËN DHE LISTËN E DOKUMENTEVE TË BASHKËLIDHURA

Vërtetim regjistrimi kërkesë
(NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE)

Nr. ____ Prot. _____, më ____ / ____ 201....

Lënda: Vërtetim regjistrimi kërkesë për përfitimin nga programet es trehimit social

Drejtuar: Z./Znj..... (adresa)

I nderuar Z./Znj.....,

Vërtetojmë se ju keni paraqitur kërkesën me nr. _____ protokolli, datë _____, e cila është regjistruar pa të meta pranë..... (njësia e vetëqeverisjes vendore), me anë të së cilës paraqisni preferencën tuaj për përfitimin nga programi _____ i strehimit social. Kërkesa juaj është regjistruar me nr. _____ në regjistrin elektronik të sistemit të pikëzimit.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë janë depozituar edhe dokumentet, si më vijon:

	TITULLI I DOKUMENTIT	NR. I FAQEVE

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

(Emrin i punonjësit firma)

